



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:049049

Datë: 02.05.2023

Numri i dokumentit: 04238383

S Sh -Prizren.

E përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati Sh R Prizren

*Paditësja*

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 02.05.2023, mori këtë:

### AKTGJYKIM

**I. Miratohet pjesërisht** si bazuar kërkesëpadia e paditëses S Sh dhe NDRYSHOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit PRZ009-0250, dt. 06.03.2015, ashtu që detyrohet e paditura Agjencia Kosovare e Privatizimit, që paditëses t’ia paguaj shumat si në vijim:

- Shumën prej 450.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për vitin 2011;
- Shumën prej 1,185.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për vitin 2013;
- Shumën prej 900.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për vitin 2014;

Në shumën e përgjithshme prej 2,535.33 €, si dhe shumën prej 253.00 €, në emër të kamatës së vonesës prej 10 % të shumës së detyrimit bazë, në shumën totale për pagesë prej 2,788.00 €, e cila shumë duhet të shpërndahej tek paditësja, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

**II. Refuzohet pjesërisht** si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses S Sh në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara, respektivisht mbi shumën bazë të aprovuar me këtë aktgjykim prej 2,535.33 €, e deri në shumën e kërkuar prej 5,613.24 €.

**III.** Detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj shumën prej 268.00 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së

përcaktuar të kërkesave dhe interesave të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm për likuidimin e NSH-ve.

### **Rrethanat procedurale të çështjes**

Me datën 23.03.2015, paditësja ka paraqitur padi pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit (AL), me shenjën PRZ009-0250, dt. 06.03.2015.

Në padi ndër të tjera është theksuar: paditësja me NSH Progres-Drejtoria Lavërtari dhe Blegtori kishte lidhur kontratën mbi veprën për kryerjen e punëve – të gjitha obligimet e kontabilitetit, financiar - bilancin përfundimtar. Punimet nga kjo kontratë mbi veprën i ka kryer pa orar në afat sipas natyrës së punës dhe rregullave të kontabilitetit. Në bazë të kontratës NSH-ja ka marrë për obligim që në emër të punëve të kontabilitetit paditëses t'ia paguaj shumën prej 150.00 €, në muaj. Më tutje ka shtuar se i ka përmbushur detyrimet nga kontrata mbi veprën ngase i ka kryer të gjitha punët e kontabilitetit, ndërsa pala e paditur nuk i ka përmbushur në tërësi detyrimet lidhur me pagat. Nga kjo kontratë pala e paditur i ka mbetur në borxh si në vijim: prej muajit të 3-të e deri në muajin e 6-të të vitit 2005; prej 01.03.2006, deri me 31.12.2006; për tërë vitin 2007; për tërë vitin 2009; për tre muaj të vitit 2011; prej muajit të parë e deri në muajin e 7-të të vitit 2013; dhe prej 01.01.2014 deri me 30.06.2014, në shumën e përgjithshme prej 5,248.00 €. Më tutje, ka theksuar se për realizimin e borxhit kishte parashtruar kërkesë kreditore pranë AL-së, mirëpo AL me vendimin e kontestuar kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar dhe me aktgjykim të shfuqizohet vendimi i AL-së dhe të detyrohet pala e paditur që t'ia kompensoj shumën prej 5,248.00 €. Me padi ka dorëzuar edhe vendimin e atakuar të AL-së, me numër PRZ0009-0250.

Me datën 11.06.2021, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimeve të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tyre me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur. Po ashtu, përgjigja në padi i referohet nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ka pretenduar se kërkesa kreditore është e parashkruar ngase pala paditëse nuk i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent në afatin prej 3 viteve nga momenti i arritjes së kërkesës e që është viti 2004. Me përgjigje në padi është propozuar që të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohen vendimet e lëshuara nga AL.

Me datën 28.07.2021, paditësja ka dorëzuar pranë kësaj gjykate përgjigje në përgjigjen në padi të të paditurit, ku ndër të tjera ka theksuar: pranë AL-së ka parashtruar kërkesë kreditore brenda afatit për parashtrimin e kërkesave po ashtu kërkesës i ka bashkangjitur edhe prova të mjaftueshme dhe se janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 40 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034. Më tutje, ka theksuar se nga lista e pagave e evidentuar pranë Raiffeisen Bank dëshmohet se në xhirollogarinë e saj nuk janë paguar pagat mujore si në vijim: për vitin 2005 shuma prej 750.00 €; për vitin 2006 shuma prej 1,080.00 €; për vitin 2007 shuma prej 966.24 € për vitin 2008 shuma prej 26.00 €; për vitin 2009 shuma prej 312.00 €, për vitin 2011 shuma prej 450.00 €; për vitin 2013 shuma prej 960.33 €; për vitin 2014 shuma prej 900.00 €, borxhi i përgjithshëm është në shumën prej 5,348.00 €. Në lidhje me pretendimin e palës së paditur e cila ka pretenduar se kërkesa është e parashkruar ka theksuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Me datën 24.08.2021, pala paditëse ka paraqitur kundërpërgjigje, ku ndër të tjera ka theksuar: se rregull bazik i procedurës civile-kontestimore është se pala paditëse e ka barrën e provave dhe se pala paditëse nuk ka paraqitur ndonjë argument të ri mbi të cilin e mbështet pretendimin e sajë. I ka propozuar gjykatës së kërkesëpadinë ta refuzoj si të pa bazuar.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate, të datës 02.09.2021, është refuzuar kërkesëpadia si e pa bazuar. Kolegji i Apelit i kësaj gjykate, në procedurë ankimore, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

### **Gjendja faktike e konstatuar**

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”*.

Pala paditëse ka dorëzuar provat si në vijim: listën e punëtoreve të angazhuar në punë në ndërmarrje; listën e pagave të pa paguara; dëshmi të deklaratës tatimore në te ardhurat e korporatave; pasqyrën tremujore të pagesës paradhënien për korporatat e mëdha; pasqyrën e llogarisë së Trustit për palën paditëse; formularin e deklarimit të pagesës së TVSH-së; listën e pagave të paguara dhe të pa paguara; kontratën mbi veprën të lidhur me ndërmarrjen. Nga ana tjetër, e paditura ka dorëzuar këto prova: Tabela 6.4 – Lista e Rrogave të Papaguara; dhe Kontrata mbi Veprën dt. 30.01.2013.

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë analizën e fakteve dhe provave të prezantuara nga palët në procedurë, konform rregullave që rrjedhin nga neni 8.1 i LPK-së dhe dispozitat tjera ligjore të ndërlidhura.

- Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe analiza e provave të prezantuara, gjykata ka ardhur në përfundimin se faktet vendimtare të prezantuara nga pala paditëse, janë jo kontestuese, madje të mbështetura edhe në provat që ka prezantuar, si në vijim: Paditësja ka qenë punëtore me kontratë mbi veprën pranë NSH “ Lavërtari-Blegtori”, me seli në Prizren, deri me fillimin e procedurës së likuidimit të sajë, respektivisht deri me datën 19.08.2014, kur AKP-ja i ka dërguar njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënie së punës. Në bazë të kontratës në fjalë, pala paditëse ka kryer shërbime të kontabilitetit për ndërmarrjen, ndërsa ndërmarrja ka marrë detyrimin e pagimit të shumës prej 150.00 €, në muaj në emër të shërbimit të kryer. Nga parashtrimet e palës paditëse rrjedh se pala e paditur nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet e marra nga kontrata mbi veprën, respektivisht nuk ia ka paguar pagat mujore, siç janë specifikuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Pala paditëse ka paraqitur kërkesë kreditore pran AL-së, për pagesën e pagave të mbetura të papaguara që i takojnë periudhës 2004 - 2014, në shumën totale prej 5,248.00 €. AL e ka refuzuar kërkesën kreditore në tërësi dhe gjatë gjykimin ka pretenduar se kërkesa kreditore është e parashkruar.
- Pala e paditur nuk e ka kontestuar faktin se me palën paditëse ka qenë në raport kontraktues nga kontrata mbi veprën, e po ashtu nuk e ka kontestuar as faktin se pagesa mujore ka qenë në shumën prej 150.00 €. E vetmja bazë mbi të cilën pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë ka qenë parashkrimi i kërkesës. Andaj sipas vlerësimit të gjykatës kontesti në fjalë është i natyrës së pastër ligjore respektivisht varet nga çështja se a është parashkruar e drejta e paditësit për të paraqitur kërkesën kreditore, apo jo.

## Arsyetimi ligjor

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pran Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

*- Neni 4.1: Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.*

*- Neni 4.2: Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.*

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritor pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 398 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

*“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Po ashtu, me nenin 152 të LPK-së (aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes), është përcaktuar: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Siç është shtjelluar më sipër, në këtë çështje kontestimore, faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese. Sikurse vendimi i AL-së i atakuar me padi, ashtu edhe përgjigja në padi e paraqitur nga AKP-ja dhe parashtrimet e tjera të mëvonshme, nuk i kontestojnë faktet dhe rrethanat në të

cilat thirret pala paditëse në kërkesën kreditore dhe me kërkesëpadi. Por, refuzimi i kërkesës është mbështetur vetëm në pretendimin se kërkesa kreditore është parashkruar.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritore (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme. Nga parashtrimet e palëve në procedurë dhe provat e shqyrtuara, rezulton se kontesti në mes të palëve në procedurë është i natyrës së pastër ligjore, ku pala e paditur ka pretenduar se kërkesa kreditore për pagat e pretenduara është parashkruar, ndërsa pala paditëse ka pretenduar se i takon e drejta në paga dhe se nuk ka parashkrim në këtë rast konkret.

Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në emër të shërbimeve të kryera për periudhën 2004-2014, dhe prapësimi i parashkrimit, i paraqitur nga e paditura. Gjukata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia është e bazuar, përkitazi me pagesat që i takojnë periudhës shtator 2011 - gusht 2014, ndërsa e njëjta nuk ka bazë ligjore për pagat e tjera të kërkuara, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Gjukata potencon se sikurse legjislacioni që ishte në fuqi para vitit 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite”. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se “Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç.

Pas vlerësimeve të bëra në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa për pagesat e papaguara që i takojnë periudhës shtator 2011 – gusht 2014, nuk është parashkruar, ndërsa kërkesa për pagat e tjera të mëhershme, është parashkruar. Po ashtu duke u bazuar në kontratën e datës 30.01.2013, gjykata e ka vërtetuar faktin se pala paditëse ka ofruar shërbime për palën e paditur për periudhën në fjalë.

Gjukata potencon se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Ndërmarrje i datës 19.08.2014, e ka ndërprerë parashkrimin për tri vitet paraprake, respektivisht për pagat që i takojnë periudhës nga muaji shtator 2011 e tutje. Ndërsa pagat e mëhershme e kanë arritur afatin tre vjeçar të parashkrimit, para se të jepej njoftimi nga pala e paditur. Gjukata ka ardhur tek ky konstatim, në mbështetje të nenit 368, paragrafi 1 te LMD-së, ku është e përcaktuar se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pra, në rastin konkret gjykata ka ardhur në përfundimin se letër pezullimi i datës 19.08.2014, ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit. Prandaj, gjykata ka konstatuar se nuk janë parashkruar detyrimet e të paditurës përkitazi me pagat e mbetura të papaguara gjatë periudhës nga muaji shtator 2011 – gusht 2014, ndërsa pagat e kërkuara që i përkasin periudhës para muajit shtator 2011, janë të parashkruara dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i mbrojtjes gjyqësore.

Sa u përket pagave të cilat nuk janë parashkruar për periudhën 2011-2014, gjykata ka konstatuar se pala paditëse për vitin 2011, nuk është kompensuar për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor në shumën prej 450.00 € (3X150=450); për vitin 2012, është kompensuar me tepër në shumën prej 164.67 €; për vitin 2013 nuk është kompensuar për muajt maj-dhjetor në shumën prej 1,200.00 € (8X150=1,200.00), meqenëse pala paditëse në vitin 2012, është paguar me tepër në shumën prej 164.67 €, gjykata e ka zbritur këtë shumë duke ia aprovuar vetëm shumën prej 1,185.00 €; dhe për vitin 2014, nuk është kompensuar në për muajt janar-qershor në shumën prej 900.00 € (6X150=900.00 €). Përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se borxhi i përgjithshëm e palës së paditur për periudhën në fjalë është në shumën e përgjithshme prej 2,535.00 €.

Siç është cekur me lartë pala e paditur nuk e ka kontestuar faktin se me palën paditëse ka qene në raport kontraktues nga kontrata mbi veprën, e po ashtu nuk e ka kontestuar as faktin se pagesa mujore ka qenë në shumën prej 150.00 €.

Rrjedhimisht gjykata ka vendosur për miratimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë, si në paragrafin I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën e vonesës është i bazuar në neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, paragrafi 1 dhe 2, është përcaktuar se *“Aktgjykimi i formës së prerë lidhur me një kërkesë apo ankesë duhet të përfshijë një vendim për shpenzimet e lëndës në mes të palëve. Pala e pasuksesshme urdhërohet t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me aktgjykimin e formës së prerë”*. Në këtë çështje kontestimore, pala paditëse ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar ato. Gjukata, konform dispozitave të lartpërmendura, në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Taksat Gjyqësore dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, ia ka njohur paditësit të drejtën në kompensimin e shpenzimeve procedurale, pasi i njëjti e ka fituar gjykimin, në shumën si në vijim: 104.00 € për përpilimin e padisë nga avokati; dhe 30.00 €, në emër të taksës gjyqësore për padi; 104.00 € për kundërpërgjigje në mbrojtjen e palës së paditur; 30.00 €, për ankesë; në shumën e përgjithshme prej 268.00 €.

### **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,**  
**Mr.sc. Bajram Miftari**